



VENDIM
Nr.59 Datë 08.09.2010

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HYDROENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, gërma “g”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.09.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HydroEnergy” sh.p.k për licensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

Dhe konstatoi se :

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1)
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2).
- o Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10)

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “HydroEnergy” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA